



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Primiemo/Prodato Received/Delivery	18.07.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojç Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	5269/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.817/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.817/2023 të datës 06.06.2023 të parashtruar nga ankuesi Labinot Shabani, të cilin me autorizim e përfaqëson Valentina Prishtinë, kundër organit të punësimit Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.817/2023 e datës 06.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Anullohet Vendimi Nr.08/27-665-2023 i datës 19.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Vendimi Nr.02-375-2023 i datës 06.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

III. Mbetet në fuqi shpallja e Konkursit me numër KQZ-16/2023 të datës 24.02.2023, për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (zotues), si dhe çdo veprim procedural i ndërmarr deri në nxjerrjen e Vendimit Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

IV. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative në mënyrë që procedura e rekrutimit sipas Konkursit me numër KQZ-16/2023 të datës 24.02.2023 të vazhdoj me fazën e intervistimit me gojë të kandidateve sipas Raportit të datës 04.04.2023 të Komisionit Përzgjedhës për vlerësimin e testeve me shkrim të kandidateve pjesëmarrës.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi *(tutje vetëm ankuesi)* më datë 06.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.817/2023, kundër Vendimit Nr.08/27-665-2023 të datës 19.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimet ankimore se anulimi i konkursit për pozitën e Zyrtarit të Lartë Financiar(zotues) është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuases të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *(në tekstin e mëtejme Këshilli)* në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa kjo e fundit më datë 13.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4601/2023 e datës 06.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 31.05.2023 nga përfaqësuesja e ankuesit; Aktgjykimin me Nr.ref.AGJ 1363/19 të datës 20.05.2019 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Konkursin KQZ-16/2023 të datës 24.02.2023; Vendimin me Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të KQZ-së; Vendimin me Nr.08/27-665-2023 të datës 17.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigjen në kërkesë me Nr.02-400/A-2023 të datës 19.04.2023 nga Kryeshefi Ekzekutiv i KQZ-së; Raportin me Nr.06-328-2023 të datës 27.03.2023 nga kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë; Raportin e datës 04.04.2023 nga Komisioni Përzgjedhës për vlerësimin e testeve me shkrim; Testin me shkrim të datës 29.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.06.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.06.2023 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kërkesën për fillimin e procedurës së rekrutimit të datës 09.02.2023; Vendimin për themelimin e Komisionit Përzgjedhës me Nr.02-283-2023 të datës 10.03.2023; Regjistrin e aplikacioneve të pranura të datës 24.02.2023; Raportin nga Komisioni Përzgjedhës për vlerësimin e testeve me shkrim të kandidatëve pjesëmarrës të datës 04.04.2023; Vendimin me Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 për anulimin e konkursit në fjalë; Ankesën e ankuesit me Nr.09/527-2023 të datës 25.04.2023 e parashtruar të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr.08/27-665-2023 të datës 19.05.2023 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin zyrtar të datës 19.05.2023 lidhur me dërgimin e vendimit të komisionit për ankuesin nga njësia e burimeve njerëzore; Formularin Form.KQZ-R-05 të datës 23.03.2023 lidhur me përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Kërkesën urgjente përmes e-mailit zyrtar të datës 31.03.2023 nga M.M për tek Kryeshefi Ekzekutiv; Komunikimet elektronike përmes e-mailave zyrtar për datat 27.03.2023 lidhur me

njoftimin e kandidatëve për listën e ngushtë; Komunikimet elektronike përmes e-maileve zyrtare për datat 05.04.2023, 04.04.2023 lidhur me njoftimet për vendimin për anulimin e procesit të rekrutimit për pozitën në fjalë, Raportin e vlerësimit të testeve më shkrim nga anëtarët e komisionit me udhëheqësen e burimeve njerëzore; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 31.03.2023 nga anëtari i komisionit N.H lidhur me dorëheqjen nga komisioni përzgjedhës; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 07.04.2023 lidhur me anulimin e konkursit; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 31.03.2023, 30.03.2023 dhe 29.03.2023 nga kryesuesja e komisionit M.M lidhur me lajmërimin për dorëheqjen nga anëtari i komisionit; Komunikimet elektronike për datat 23.03.2023, 22.03.2023 ndërmjet anëtarëve të komisionit, Kryeshefit të institucionit dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore; Testet me shkrim të kandidatëve pjesëmarrës të datës 29.03.2023; Kërkesën për punësim të datës 13.03.2023 të kandidatës V.Z së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të datës 13.03.2023 të kandidatës R.R së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim ; Kërkesën për punësim të datës 06.03.2023 për ankuesin së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të datës 06.03.2023 të kandidatit G.XH së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të datës 02.03.2023 të kandidatës E.M-P së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të kandidatës D.J së bashku me së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të datës 07.03.2023 të kandidatit B.H së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të kandidatës A.B-M së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të datës 13.03.2023 nga kandidatja A.M së bashku së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim; Kërkesën për punësim të datës 10.03.2023 nga kandidatja A.S-A së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për aplikim.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit janë të *bazuara, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (me tej SKQZ) më datë 24.02.2023 ka publikuar Konkursin me numër KQZ-16/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Financa (zotues)* në Divizionin për Buxhet dhe Financa, në nivelin profesional-G 7/K-12.8 , me afat të aplikimit nga data 23.02.2023 deri 13.03.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është përfshirë në listën e ngushtë së bashku me dhjetë (10) kandidatët e tjerë sipas Raportit të Komisionit Përzgjedhës lidhur me përgatitjen e listës së ngushtë me Nr.06-328-2023 të datës 27.03.2023.

Tutje nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 04.04.2023 Komisioni Përzgjedhës i themeluar sipas Vendimit Nr.02-283-2023 të datës 10.03.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, ka hartuar raportin mbi vlerësimin e testeve me shkrim sipas të cilit del se nga dhjetë (10) kandidatët që i janë nënshtruar testimit me shkrim, vetëm dy (2) nga kandidatët përfshirë edhe ankuesin kanë kaluar fazën e testimit me shkrim, njëherazi duke propozuar që mbajtja e intervistës me gojë të realizohet më datën 06.04.2023.

Me Vendimin Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së është anuluar Konkursi me numër KQZ-16/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Financa (zotues)* për shkak të dorëheqjes së dy anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës me arsyetimin se dorëheqja në fjalë paraqet problem serioz në vlerësimin dhe përzgjedhjen meritore bazuar në parimin e shanseve të barabarta,

mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanshmërisë dhe se procesi në fjalë e ka humbur kredibilitetin.

Ankuesi i pakënaqur me anulimin e Konkursit sipas Vendimit me Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023, ka parashtruar ankesë te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr.08/27-665-2023 të datës 19.05.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar duke lënë në fuqi Vendimin Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së për anulimin e konkursit në fjalë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër Vendimit me Nr.08/27-665-2023 të datës 19.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është marrë me shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, ngase i njëjti fare nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të tij në ankesën e parashtruar me datën 25.04.2023 sa i përket përgatitjes së testimit me shkrim nga ana e Komisionit Përzgjedhës, se anulimi i konkursit për pozitën e lartcekur ka qenë tendencioz dhe jo fer të cilën gjë nuk ka arritur të vërtetoj se anulimi i konkursit nuk është i bazuar dhe se me këtë rast ankuesit i është mohuar e drejta e punësimit, dizpozitivi i Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është në kundërshtim me arsyetimin e tij konkretisht me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ankuesi propozon që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Vendimi me Nr.08/27-665-2023 i datës 19.05.2023 i KZKA-së dhe Vendimi me Nr.02-375-2023 i datës 06.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-zë.

Referuar konkursit të datës 24.02.2023 me numër KQZ-16/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Financa* në Divizionin për Buxhet dhe Financa si kushte lidhur me kualifikimin, aftësitë dhe përvojën e punës janë përcaktuar: *Diplomë Universitare në Ekonomi, Financa dhe të ngjashme; Tre (3) vite përvojë pune profesionale; Integritet të lartë personal dhe profesional; Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare; Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike; Njohja e gjuhës tjetër zyrtare; Njohja e gjuhës angleze me gojë dhe me shkrim e dëshirueshme* Rrjedhimisht, Këshilli sipas nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji Këshillit ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike lidhur me këtë çështje dhe në këtë mënyrë gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase bazuar në provat materiale të lëndës, Kolegji ka gjetur se procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 24.02.2023 me numër KQZ-16/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Financa*, është anuluar për shkak të dorëheqjes së dy anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës Nexhmedin Hyseni dhe Vuksan Vuksanovic, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së me rastin e vendosjes sipas ankesës së ankuesit, nuk kishte marrë parasysh faktin, se dy anëtarët e dorëhequr me datë 29.03.2023 kanë pjesë në përgatitjen e formës së testit me shkrim (i hartuar sipas çelësit të përgjigjeve të sakta) dhe se të njëjtit janë pajtuar lidhur me përmbajtjen e pyetjeve të testit si dhe kanë marrë pjesë në testimin e realizuar me datë 29.03.2023, fakt ky që vërtetohet përmes nënshkrimit të formës së testit nga të gjithë anëtarët e Komisionit Përzgjedhës pra edhe nga dy anëtarët e dorëhequr si dhe Raportit të datës 04.04.2023 të Kryesueses së Komisionit Përzgjedhës, rrjedhimisht mbi bazën e këtyre konstatimeve rezulton se dorëheqja e dy anëtarëve në fazën pas vlerësimit të testimit me shkrim nuk ka mbështetje ligjore dhe

se nuk përbënë shkak për anulimin e kësaj procedure të rekrutimit, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Përkitazi me pretendimin ankimor se Vendimi Nr.08/27-665-2023 i datës 19.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit nga analizimi i të njëjtit ka konstatuar se arsyetimi i këtij vendimi është në kundërshtim me vet dispozitivin, sepse në dispozitiv të vendimit është refuzuar ankesa e ankuesit e datës 25.04.2023 e parashtruar kundër vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së për anulim të konkursit, ndërsa në arsyetimin e vendimit të goditur me ankesë, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me dorëheqjen e anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës është i bazuar, fakt ky që ankesën e ankuesit të datës 25.04.2023 e ka bërë tërësisht të bazuar ngase anulimi i konkursit është bërë mu për shkak të dorëheqjes së dy anëtarëve të komisionit. Për më tepër, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së fare nuk është lëshuar në trajtimin e ligjshmërisë së Vendimit për anulimin e konkursit si një nga pretendimet tjera të ankuesit të parashtruar në ankesën e datës 25.04.2023, veprim ky që në vlerësimin e Kolegjit bie ndesh me dispozitat e nenit 134 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë..”*

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit referuar Vendimit me Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së për anulimin e Konkursit KQZ-16/2023 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Financa*, ka gjetur se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë..”* si dhe nenin 48 të këtij ligji me të cilin përcaktohet se: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsye të tjera që janë zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”* ngase Vendimi Nr.02-375-2023 i datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ nuk përmban shpjegim të situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave përkatësisht që kanë sjellë anulimin e konkursit, bazën ligjore të vendimmarrjes si dhe udhëzimin për të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike.


Nisur nga konstatimet si më lartë, përkatësisht duke qenë se Vendimi Nr.08/27-665-2023 i datës 19.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së si dhe Vendimi Nr.02-

375-2023 i datës 06.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQK-së janë përfshirë me shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit në kuptim të nenit 52 paragrafit 1, nën paragrafët 1.3, 1.4, dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një akt administrativ i nxjerrë si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ si dhe në kundërshtim me ligjin material është akt i paligjshëm, andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji i Këshillit ka vlerësuar vetëm ligjshmërinë e akteve të kontestuara me ankesë dhe nuk ka trajtuar çështjen e ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit për pozitën në fjalë, ligjshmëri kjo që mund të kundërshtohet me ankesë me rastin e përfundimit të kësaj procedure të pranimit. Si rrjedhojë Kolegji ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar, ka anuluar Vendimin Nr.08/27-665-2023 e datës 19.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe Vendimin Nr.02-375-2023 e datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, ndërsa ka lënë në fuqi shpalljen e Konkursit me numër KQZ-16/2023 të datës 24.02.2023, për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (zotues), si dhe çdo veprim procedural i ndërmarrë deri në nxjerrjen e Vendimit Nr.02-375-2023 të datës 06.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, duke obliguar të njëjtin që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative në mënyrë që procedura e rekrutimit sipas Konkursit me numër KQZ-16/2023 të datës 24.02.2023 të vazhdojë me fazën e intervistimit me gojë për kandidatët sipas Raportit të datës 04.04.2023 të Komisionit Përzgjedhës për vlerësimin e testeve me shkrim.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.817/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses me autorizim të ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.